



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0874

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së OE Eko Term SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse” me numër të prokurimit 626-25-5557-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E MAMUSHËS, më 28.10.2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjeserishte e bazuar ankesa e Eko Term SH.P.K., me nr. 2025/0874, e datës 08.09.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse”, me numër të prokurimit 626-25-5557-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – KOMUNA E MAMUSHËS.
2. Mbetet në fuqi B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - KOMUNA E MAMUSHËS për aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse”, me numër të prokurimit 626-25-5557-5-2-1.
3. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues aprovohen si pjeserishtë, të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 20.06.2025 KOMUNA E MAMUSHËS, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse”, me numër të prokurimit 626-25-5557-5-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: pumë, vlera e parashikuar e kontratës: 90,000.00 €.

Me 21.08.2025 KOMUNA E MAMUSHËS., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), për aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse”, me numër të prokurimit 626-25-5557-5-2-1 ka rekomanduar për kontratë GOE Asi Project SH.P.K.; TRIANGLE SH.P.K.,Rr. Fadil Elshani.

Me 26.08.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 29.08.2025 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 08.09.2025, OE Eko Term SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokoli 2025/0874, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Eko Term SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Përmes platformës elektronike të KRPP-së njoftohemi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me dt. 21.08.2025 se për aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse" me numër të prokurimit 626-25-5557-5-2-1 & 626-25-007-5-2-1, është shpallur fitues Grupi i Operatorëve Ekonomik ASI PROJECT SH.P.K. & TRIANGLE SH.P.K.

Të pakënaqur me këtë vendim, në bazë të dispozitave të LPP-së, kemi bërë kërkesë për qasje në dokumentacionin e tenderit fitues me dt. 21.08.2025 dhe me dt. 22.08.2025 në ora 14:00 na është ofruar qasje në dokumentacionin e tenderit. Qasja në dokumentacion nuk na është dhënë në tërësi nga AK me arsyetimin që operatori ekonomik ka dërguar kërkesën për sekret afarist për kapacitetin ekonomik dhe teknik e profesional, me ç'rast na është prezantuar edhe kërkesa për sekret afarist nga GOE, mirëpo si pasojë e mosqasjes në tërësi në dokumentacion, na është kufizuar edhe mundësia për të shikuar nëse GOE i propozuar për kontratë ka plotësuar në tërësi kërkesat e AK. Në dokumentet në të cilat kemi pasur qasje, konstatojmë se gjatë vlerësimit të tenderit Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e LPP-së, respektivisht Neni 7, Neni 56, Neni 59, Neni 60, Neni 61, Neni 66 dhe Neni 72, duke shpallur fitues Grupin e Operatorëve ASI

PROJECT SH.P.K. & TRIANGLE SH.P.K., të cilët pas shikimit të dokumentacionit të tenderit (paramasës dhe parallogarisë) rezultojnë të përgjegjshëm dhe atë me çmim jonormalisht të ulët.

Pretendimi 1.

Grupi i Operatorëve Ekonomik të rekomanduar për shpërblim me kontratë, për poz. 1 Grupi D — Furnizimi, demolimi dhe montimi i kaldajave me lëndë djegëse të ngurtë P-350 KW (prodhuesi “CENTROMETAL” TVT) ose i barazvlefshëm, kanë ofruar çmim tejet të ulët dhe jo serioz në vlerë prej 4,500.00 euro/cope, kur dihet se çmimi i tregut për këtë pajisje sillet nga 7,000.00 - 8,000.00 euro. Gjithashtu në këtë pozicion Grupi i Operatorëve Ekonomik i rekomanduar për shpërblim me kontratë bie në kundërshtim me pozicionin 61 Grupi D të të njëjtit furnizim dhe shërbim, ku ka vendosur çmimin 5 euro (që të dy pozicionet 1 dhe 61 Grupi D janë paraparë të kryhen me të njëjtat materiale).

Grupi i Operatorëve Ekonomik të rekomanduar për shpërblim me kontratë, për poz. 54 Grupi D — specifikat e ashensorit “Furnizimi dhe vendosja e ashensorit” me këto karakteristika: technical data for dhe model: ELECTRIC MRL STATIONS, kanë ofruar çmim tejet të ulët dhe jo serioz në vlerë prej 3,300.00 euro/cope, kur dihet se çmimi i tregut është rreth 18,000.00 euro.

AK gjatë vlerësimit të ofertës së GOE ASI PROJECT SH.P.K. & TRIANGLE SH.P.K. ka dërguar kërkesë për sqarime shitesë për pozicionet si më poshtë:

Çmimet jonormalisht të ulëta:

Pjesa A: Pozicionet 14, 16 dhe 17.

Pjesa B: Pozicionet 3, 8, 14, 15, 16, 17 dhe 19.

Pjesa C: Pozicionet 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10.

Pjesa D: Pozicionet 5, 6, 7, 10, 12, 13, 14, 28, 31, 32, 33, 34, 36, 38, 40, 41, 42, 43, 44, 52, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62 dhe 63.

Çmimet tepër të larta:

Pjesa A: Pozicioni 1.

Pjesa B: Pozicionet 3 dhe 18.

Pjesa D: Pozicionet 47, 48, 49, 50 dhe 51.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë të tenderit tuaj, kërkojmë që së bashku me informatat të na dërgoni referencat në të cilat jeni bazuar me rastin e vendosjes së çmimeve, si dhe si dëshmi të na dërgoni kopje të faturave së bashku me transfer bankar apo të kontratave të realizuara për furnizime të ngjashme, në të cilat evidentohen artikujt e lartcekur, si dhe çdo kusht veçanërisht të favorshëm që është në dispozicionin tuaj për të kryer furnizimet, shërbimet dhe punët e paraqitura në paramasën e projektit.

Pas kërkesës për sqarim, GOE ka dërguar sqarim për disa pozicione, përpos pozicionit 61 të Grupit D ku GOE nuk ka ofruar fare dokument mbështetës si: fatura apo kontrata për furnizime të ngjashme për pajisjen ashtu siç është kërkuar nga AK. Gjithashtu, AK gjatë kërkesës për

sqarim drejtuar GOE të propozuar për kontratë nuk ka kërkuar fare sqarim as për pozicionin 54 Grupi D në paramasë (një pozicion me peshë), meqë kjo pajisje ka një çmim të lartë në treg. Edhe pas kërkesës për rishqyrtim, përsëri AK nuk ka marrë fare për bazë kërkesën tonë për pozicionin 61 dhe 54 të Grupit D në paramasë, për të kërkuar nga GOE sqarime dhe dokumente (fatura) si dëshmi rreth çmimit të pajisjeve të përfshira në poz. 54 dhe 61 të Grupit D në paramasë.

KONSTATOJMË se GOE ka dështuar të ofrojë sqarime me dokumente mbështetëse si (kopje të faturave së bashku me transfere apo kontrata të realizuara për furnizime të ngjashme), në të cilat evidentohen artikujt si në pozicionet 54 dhe 61 të Grupit D në paramasë. Bashkëngjitur gjeni paramasën për pozicionet e lartcekura, letrën standarde B41 të dërguar nga AK për GOE dhe dokumentet mbështetëse të ofruara nga GOE gjatë sqarimit (Prova materiale 1).

Gjithashtu, gjatë vlerësimit të ofertës (paramasës dhe parallogarisë) së GOE BAJRAM HA. GASHI B.I. & SMART ENG GROUP SH.P.K. konstatohet se Grupi i Operatorëve Ekonomik BAJRAM HA. GASHI B.I. & SMART ENG GROUP SH.P.K. për poz. 54 Grupi D — specifikat e ashensorit “Furnizimi dhe vendosja e ashensorit” me këto karakteristika: technical data for dhe model: ELECTRIC MRL STATIONS, kanë ofruar çmim tejet të ulët dhe jo serioz në vlerë prej 6,100.00 euro/cope, e kur dihet se çmimi i tregut është rreth 18,000.00 euro.

Prova materiale 1: Bashkëngjitur paramasat dhe parallogarit për GOE-të.

Rrjedhimisht, GOE është i papërgjegjshëm dhe atë në bazë të Nenit 61 të LPP-së — Tenderët Jo-Normalisht të Ulët.

Prandaj, duke shikuar të gjithë dokumentacionin e tenderit dhe ofertat e dorëzuara nga Operatorët Ekonomikë, kërkojmë nga ju që të bëni rishqyrtimin e njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 21.08.2025, të eliminoni të gjithë operatorët ekonomikë që kanë ofruar çmime jonormalisht të ulëta dhe ne të shpallemi fitues si tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Operatori Ekonomik Eko Term SH.P.K, nga Suhareka me datë 26.08.2025 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit për dhënie të kontratës nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Mamushës për projektin me titull: “Mirëmbajtja dhe ripunimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse”.

Si autoritet kontraktues, pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, menjëherë kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me vëmendje të shtuar kemi shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të vendimit.

Në pretendimet e O.E. është cekur se janë bërë shkelje të neneve: 7, 56, 59, 60, 61, 65, 66 dhe 72 të LPP-së. Konsiderojmë që të gjitha këto pretendime të shkeljes së LPP-së janë të pabaza për arsyet e cekura në vijim:

O.E. ankues, në lidhje me qasjen në dokumentacionin e tenderit, ka pretenduar që nuk i është dhënë qasja në tërësi, gjë e cila nuk është kontestuese, pasi që, sikur e kemi njoftuar me rastin e qasjes, O.E. i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar aneksin nr. 3 të dosjes së tenderit në të cilin ka kërkuar që informatat për dokumentet e kërkuara sipas neneve 68 dhe 69 të LPP-së të mbeten sekrete afariste, si dhe ka dhënë arsyetimin dhe ka përcaktuar dokumentet të cilat duhet të

trajtohen si të tilla.

AK, pasi ka bërë versionin e pastruar të dokumenteve të Grupit të O.E. të rekomanduar, me kërkesë të O.E. ankues i ka dhënë qasje në dokumentacionin e pastruar, në të cilin rast i ka prezantuar të gjitha këto dokumente, si dhe sipas kërkesës së tyre, përmes diskutimit, iu ka dhënë një kopje të dokumenteve të versionit të pastruar. Pra, pas kërkesës për qasje në dokumentacionin e tenderit të njëjtit iu është dhënë qasja dhe nuk ka pasur vërejtje lidhur me dokumentet e marra, gjë e cila vërtetohet me procesverbalin e datës 22.08.2025 ora 14:30 min.

Sa i përket pretendimit se janë shkelur dispozitat e nenit 7 të LPP-së, konsiderojmë që ky pretendim është i pabazë pasi që ne, të gjithë pjesëmarrësit, i kemi trajtuar në mënyrë të barabartë pa kurrfarë diskriminimi dhe procedurën e hapur për prokurimin në fjalë e kemi udhëhequr në mënyrë transparente dhe në përputhje të plotë me legjislacionin e prokurimit në fuqi.

Të gjitha dokumentet e procedurës janë ngarkuar në platformën e-prokurimi dhe në ueb-faqen e Komunës së Mamushës, andaj është për t'u habitur pretendimi i O.E. ankues se procedura nuk është zhvilluar në mënyrë transparente apo se kemi diskriminuar ndonjë O.E.

Aktiviteti i prokurimit është udhëhequr në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 4 paragrafi 4.3 të RREGULLORES NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, të cilat parashohin:

Citat: “Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:

a. Konkurrenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efikase dhe më efektive.

b. Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për paranë për Autoritetin Kontraktues.

c. Drejtësia/Mos-diskriminimi – të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatorin Ekonomik ose Operatorin Ekonomik potencial. Të shmanget çdo trajtim që favorizon ndonjë furnizues të caktuar ose furnizues potencial.

d. Objektivitet/Integritet/Sinqeritet – të deklarohej çdo konflikt interesi që afekton ose paraqet afektim të vendimit; të refuzohen dhurata, mikpritje dhe benefite të çfarëdolloji nga Operatorët Ekonomikë ose Operatorët Ekonomikë potencialë, të cilat mund të paraqesin komprometim të objektivitetit ose integritetit.

e. Transparenca – të sigurohen kushte dhe qasje të barabartë për informim në mënyrë të hapur dhe transparente.

f. Llogaridhënia – të ketë llogaridhënie për përgjegjësitë e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra dhe regjistrimin e të dhënave të nevojshme.

g. Profesionalizmi – të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira.”

Sikur shihet në kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga ana e Grupit të O.E. ankues, i njëjti nuk ka paraqitur asnjë dëshmi apo fakt të ri që do të dëshmonte shkelje të dispozitave të lartcekura, andaj konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pabazë.

Gjithashtu, O.E. pretendon se nuk është zbatuar neni 56, kurse ne si AK kemi aplikuar në përpikëri nenin 56 prej fazës së përpilimit të DT, kemi aplikuar të gjitha rregullat e LPP-së, sipas RREGULLORES NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK dhe UDHËZUESIT NR.002/2024 PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, duke aplikuar nenin 51, 28 dhe 56 paragrafi 1 pika 1.1 dhe 1.2 të LPP-së.

Sa i përket pretendimit të O.E. se AK ka bërë shkelje të LPP-së, konkretisht të nenit 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderit, konsiderojmë që është i pabazuar pasi që ne kemi aplikuar me përpikëri këtë nen të LPP-së gjatë vlerësimit, si dhe kemi aplikuar me përpikëri edhe dispozitat e nenit 41 paragrafi 41.1, 41.2, 41.6 dhe 41.10 pika (a) të RREGULLORES NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, duke u përmbajtur kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Pastaj, sa i përket pretendimit të O.E. se AK ka bërë shkelje të LPP-së, konkretisht të nenit 60, duhet të sqarojmë që kriteri i dhënies së kontratës është përcaktuar në nenin 60 të LPP-së dhe me rastin e shpalljes së njoftimit për kontratë është përcaktuar shumë qartë në DT dhe Njoftimin për Kontratë, i cili ka qenë “tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët në bazë të poentimit”. Ndërsa kërkesat e pranueshmërisë dhe të kualifikimit janë kërkesa të cilat i përcakton AK për t’u konsideruar një Operator Ekonomik si i përgjegjshëm për t’u shpërblyer me kontratë.

Gjithashtu, O.E. si pretendim tjetër ka paraqitur në kërkesë se kinse është shkelur neni 61 i LPP-së. Duhet sqaruar se: neni 61 i LPP-së ka të bëjë me tenderin jo-normalisht të ulët, ku në nenin 61 pika 1 thuhet: “Nëse një operator ekonomik dorëzon një tender që është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do t’i dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim: (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit”, sipas paragrafit 2 të këtij neni.

Në bazë të nenit 61 të LPP-së, neni 4 paragrafi 4.1 pika c dhe neni 41 paragrafi 41.3 të Rregullores për Prokurimin Publik 002/2024 Ndryshim-Plotësimi i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, me datën 07.08.2025 përmes shkresës “B41 Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët” kemi kërkuar nga O.E. i rekomanduar që të na japë sqarim në lidhje me çmimet jo-normalisht të ulëta të paraqitura në pozicionet e përshkrimit të çmimeve, duke kërkuar sqarim për disa pozicione të cilat komisioni vlerësues i ka konsideruar si jo-normalisht të ulëta.

Pas marrjes së përgjigjes për sqarimin e kërkuar nga shkresa B41, komisioni vlerësues ka konstatuar se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të saj dhe ka trajtuar ofertën në mënyrën e njëjtë sikur trajton edhe tenderët e tjerë. Pra edhe ky pretendim është i pabazuar.

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar në përpikëri edhe nenin 65 të LPP-së. Në bazë të këtij neni, para vendimit për dhënie të kontratës, është kërkuar nga ana e Grupit të O.E. të rekomanduar që të sjellin dokumentet me të cilat vërtetohet përgjegjshmëria sipas këtij neni. Grupi i O.E. të

rekomanduar i ka dorëzuar këto dokumente në afatin e kërkuar. Dokumentet e njëjta i janë prezantuar edhe O.E. ankues me rastin e qasjes në dokumentacionin e tenderit, gjë e cila është cekur edhe në procesverbalin e qasjes. Andaj edhe ky pretendim i shkeljes së nenit 65 të LPP-së është i pabazuar.

Pastaj, tjetër pretendim i O.E. ankues është se kemi shkelur nenin 66 të LPP-së, ku në dosjen e tenderit në Seksionin II, Fleta e të dhënave të tenderit (FDT), te Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, neni 7.1 & 7.2, Përshtatshmëria profesionale është kërkuar që të dorëzohet kopja e certifikatës së biznesit së bashku me pjesët informative të biznesit, kopja e certifikatës së nr. fiskal nëse nuk është e përfshirë në certifikatën e biznesit, si dhe kopja e certifikatës së TVSH-së – dëshmi që të verifikohet se O.E. tenderues është kryerës i aktiviteteve për të cilat është i regjistruar. Grupi i O.E. i rekomanduar ka dorëzuar të gjitha këto certifikata me tenderin e tyre dhe këto dokumente i janë dhënë edhe O.E. ankues. Andaj pretendimi se është shkelur neni 66 i LPP-së është i pabazë.

Sa i përket pretendimit të O.E. ankues se AK ka bërë shkelje të nenit 72 të LPP-së, edhe ky pretendim nuk qëndron, pasi që Autoriteti Kontraktues ka zbatuar në përpikëri nenin 72 të LPP-së në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji. Ne gjatë procedurës së prokurimit nuk kemi pasur ndonjë kërkesë sipas këtij neni, përjashtim të kërkesës për deklaram nga Grupi i O.E. i rekomanduar që të deklarohej në lidhje me pajtimin për rritje të sigurimit të ekzekutimit.

Autoriteti Kontraktues, lidhur me pretendimet e paraqitura për pozicionet jo-normalisht të ulëta, ka kërkuar sqarim më datë 07.08.2025 nga Grupi O.E. i rekomanduar, të cilët i janë përgjigjur kërkesës së AK-së më datë 11.08.2025 ora 17:43 min. Komisioni përgjigjen e dhënë nga Grupi O.E. i rekomanduar e ka vlerësuar si të mjaftueshme dhe e ka trajtuar këtë ofertë si të përgjegjshme në bazë të legjislacionit të prokurimit në fuqi.

Duke u bazuar në nenin 119 paragrafi 29.4 të RREGULLORES NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, me qëllim të sigurimit që AK mbulon dëmet dhe shpenzimet eventuale që mund t'i ndodhin Autoritetit Kontraktues në rast të shpëputjes së kontratës, ka kërkuar që të rritet vlera e sigurimit të ekzekutimit nga 9,000.00 euro që ishte parapare në DT në 27,000.00 euro për 25 muaj. Grupi i O.E. i rekomanduar nga AK më datë 12.08.2025 ka deklaruar se e pranon rritjen e vlerës së ekzekutimit të kërkuar nga AK para nënshkrimit të kontratës. Andaj konsiderojmë që edhe pretendimi për tenderin jo-normalisht të ulët është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit që edhe Grupi i O.E. Bajram H. Gashi B.I. & Smart Eng SH.P.K. për Poz 54 Grupi D – Specifikat e ashensorit, Furnizimi dhe vendosja e ashensorit me këto karakteristika: Technical data for the model: Electric MRL Stations kanë ofruar çmim tejet të ulët dhe jo serioz në vlerë prej 3,300.00 euro/copë e kur dihet se çmimi i tregut është rreth 18,000.00 €, nuk qëndron, pasi që ky Grup O.E. ka ofruar çmimin në vlerë prej 6,100.00 €.

Pra, sikur kemi dëshmuar më lart që nga fillimi i procedurës – Njoftimi për Kontratë e deri te B58 Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, Zyra e Prokurimit KK Mamushë ka aplikuar në përpikëri të gjitha dispozitat e procedurës së prokurimit dhe se shkeljet e pretenduara nga O.E. ankues janë të pabaza.

Ne si autoritet kontraktues jemi të thirrur dhe kemi kompetenca që në rast të shpalljes, hapjes, vendimit për tender dhe gjatë gjithë procedurës tjetër, të veprojmë sipas legjislacionit në fuqi i cili rregullon fushën e Prokurimit, andaj edhe në këtë rast kemi ndjekur të gjitha hapat e kërkuara

nga LPP-ja për procedurën në fjalë.

Ndërkaq, sa i përket pretendimeve të parashtruara nga O.E. ankues që kinse kemi shkelur ligjin dhe udhëzuesin, absolutisht provat tregojnë se Autoriteti Kontraktues ka respektuar në përpikëri të gjithë procedurën, dhe konsiderojmë që pretendimet nuk janë të bazuara. Në analizimin dhe vlerësimin e përgjithshëm të çështjeve të cilat O.E. ankues i ka theksuar në kërkesën për rishqyrtim, aspak nuk mendojmë që kemi bërë shkelje të legjislacionit të Prokurimit Publik.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 11.09.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0874, ndërsa me datë 22.09.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0874, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Eko Term SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0874 ka vlerësuar si në vijim:

PRETENDIMI Nr. 1 i OE Ankues

Përmbledhje e pretendimit:

OE ankues pretendon se nuk i është dhënë qasja e plotë në dokumentacionin e tenderit fitues, për shkak të kërkesës për sekret afarist nga OE fitues (kapaciteti ekonomik, teknik dhe profesional).

Si pasojë, OE ankues thotë se është penguar të shqyrtojë nëse OE fitues ka plotësuar kërkesat e kapacitetit dhe përshtatshmërisë së parashikuara nga AK.

OE ankues pretendon se gjatë vlerësimit janë shkelur nenet e LPP-së: 7 (Barazia / Jo-diskriminimi), 56 (Përzgjedhja e pjesëmarrësve dhe dhënia e kontratës), 59 (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve), 60 (Kriteret për dhënie të kontratës), 61 (Tenderët jo normalisht të ulët), 65 (Përshtatshmëria), 66 (Përshtatshmëria profesionale), 72 (Dokumentacioni dhe informata shtesë).

Po ashtu, OE ankues pretendon se oferta fituese është me çmim jo-normalisht të ulët dhe se fituesi është i papërgjegjshëm.

Qëndrimi i Autoritetit Kontraktues (AK):

AK pranon se OE ankues ka kërkuar qasje në dokumentacionin e tenderit më 21.08.2025 dhe se me 22.08.2025, ora 14:00, i është ofruar qasje në dokumentacionin e tenderit.

Sa i përket sekretit afarist, AK thotë se OE fitues ka dorëzuar aneksin nr. 3 me kërkesë që informatat sipas nenit 68 dhe 69 të LPP të trajtohen si sekrete afariste, duke argumentuar dhe përcaktuar dokumentet e tilla.

AK shpjegon se ka përgatitur versionin e pastruar (redaktuar) të dokumenteve të OE fitues dhe ia ka dhënë OE ankues qasje në këtë version, përfshirë një kopje në USB. Procesverbali i datës 22.08.2025 ora 14:30 konfirmon se nuk ka pasur vërejtje nga OE ankues lidhur me dokumentet e marra.

Rreth pretendimeve për shkelje të neneve të LPP-së:

Neni 7 – AK kundërshton pretendimin, duke deklaruar se të gjithë operatorët janë trajtuar barabartë, se procedura është publikuar në platformën e-prokurimit dhe në faqen zyrtare të Komunës Mamushë, dhe se nuk ka diskriminim.

Neni 56 – AK pohon se ka zbatuar plotësisht këtë nen që nga faza e përpilimit të dokumentacionit të tenderit (DT), me përputhje me rregulloret dhe udhëzuesit përkatës.

Neni 59 – AK pretendon se vlerësimi dhe krahasimi i ofertave është bërë sipas kërkesave të këtij neni, dhe sipas dispozitave të Rregullores për Prokurim Publik dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Neni 60 – AK argumenton se kriteri për dhënie të kontratës është përcaktuar qartë në DT dhe në Njoftimin për Kontratë – “tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët” me poentim. Kërkesat e pranueshmërisë dhe kapacitetit janë ato që përcakton AK për të konsideruar ofertuesin si i përgjegjshëm.

Neni 61 – AK thotë se ka zbatuar këtë nen: ka dërguar shkresë standarde (B41) për informata mbi ofertat që duket se janë jo-normalisht të ulëta, ka kërkuar ndarje të komponentëve dhe shpjegime; ka marrë përgjigje nga OE fitues, dhe komisioni vlerësues e ka konsideruar ofertën si të përgjegjshme.

Neni 65 – AK deklaron se ka kërkuar dokumentet për vërtetimin e përgjegjshmërisë nga OE fitues, që këto dokumente janë dorëzuar në afatin e kërkuar dhe janë prezantuar OE ankues gjatë qasjes në dokumentacion.

Neni 66 – AK pretendon se kërkesat për përshtatshmërinë profesionale janë të qarta (kopja e Certifikatës së biznesit, certifikata fiskale nëse nuk është në dokumentet e tjera, certifikata e TVSH-së etj.), dhe se OE fitues ka dorëzuar këto dokumente; po ashtu, OE ankues i janë bërë të disponueshme gjatë qasjes.

Neni 72 – AK pohon se ka zbatuar dispozitat për dokumentacion dhe informata shtesë sipas nenit 72, dhe se gjatë procedurës nuk ka pasur kërkesë tjetër sipas këtij neni, përveç deklarimit për

sigurimin e ekzekutimit siç parashikohet.

Vlerësimi i Ekspertit për Pretendimin Nr. 1:

Eksperti vlerëson se pretendimi i OE ankues për mungesë qasjeje nuk qëndron, pasi AK ka ofruar versionin e pastruar të dokumenteve, ka respektuar kërkesën për sekret afarist, dhe dokumentet i janë dhënë në formatin e kërkuar (USB), me procesverbal.

Sa i përket pretendimeve për shkelje të neneve:

Neni 7 – Nuk ka indicie të mjaftueshme për trajtim të pabarabartë apo diskriminim; publikimi dhe disponueshmëria në platformë dhe në faqen e komunës mbështet transparencën.

Neni 56 – Dokumentacioni i tenderit dhe faza e përgatitjes së tij duket se është bërë sipas procedurave; nuk janë gjetur shkelje procedurale të parashikuara nga ky nen.

Neni 59 – Vlerësimi është bërë duke u bazuar në kriteret e shpallura; nuk ka provë se procesi i krahasimit apo ekzaminimit është devijuar nga rregullat.

Neni 60 – Kriteri për dhënie të kontratës (“tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët”) është qartë i deklaruar dhe pranuar nga pjesëmarrësit; nuk ka provë që ky kriter është interpretuar në mënyrë që favorizon në mënyrë të padrejtë OE fitues.

Neni 61 – Ky është pretendim që meriton vëmendje më të madhe; po ashtu AK ka ndërmarrë hapat e kërkuar: ka dërguar kërkesë për sqarime të ofertuesit; ka marrë përgjigje; ka vlerësuar sqarimet dhe i ka konsideruar të mjaftueshme. Eksperti konstaton se nuk ka provuar se sqarimet ishin të pamjaftueshme në mënyrë që të vërtetohet oferta si jo-përgjegjëse.

Neni 65 – OE fitues ka dorëzuar dokumentet që vërtetojnë përgjegjshmërinë, dhe këto dokumente i janë bërë të disponueshme ankuesit; nuk ka provë se AK i ka refuzuar kërkesat ose se ka mangësi vendimmarrëse.

Neni 66 – Të gjitha dokumentet që kërkohen janë dorëzuar dhe janë aksesuar nga OE ankues; nuk ka provuar mangësi profesionale të OE fitues.

Neni 72 – Nuk ka pasur kërkesa shtesë të pakryer; AK ka trajtuar informacionet dhe dokumentacionin siç parashikohet në ligj.

Eksperti vlerëson se AK ka vepruar profesionalisht dhe në përputhje me ligjin për të siguruar që oferta fituese të jetë përgjegjëse dhe se procesi i kontratës të jetë i ligjshëm.

Përfundim për Pretendimin Nr. 1:

Pretendimi i OE ankues për shkelje ligjore në nenet 7, 56, 59, 60, 61, 65, 66 dhe 72 të LPP-së është i pabazuar. Nuk ka prova të mjaftueshme që të vërtetojnë shkelje, dhe AK ka ndërmarrë të gjitha hapat që ligji kërkon në mënyrë që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë dhe vlerësim të drejtë.

PRETENDIMI NR. 2 i OE Ankuesit

(Lidhur me ofertat me çmime jo-normalisht të ulëta dhe mungesën e dokumentacionit mbështetës për pozicione specifike)

Përmbledhje e pretendimit:

OE ankues pretendon se oferta e OE fituesit për disa pozicione të caktuara – përfshirë pajisje të rëndësishme si kaldaja dhe ashensorët – është dukshëm më e ulët se çmimet reale të tregut, duke ngritur dyshime mbi realitetin financiar të ofertës.

· OE ankues pretendon se për disa pozicione (1, 54, 61) nuk janë dorëzuar dokumente mbështetëse (fatura, kontrata) siç është kërkuar në kërkesën për sqarime.

OE ankues gjithashtu vë në pah se AK nuk ka kërkuar sqarime për të gjitha pozitat që kanë pasur çmime të dyshimta dhe nuk ka trajtuar me seriozitet të duhur çështjen e çmimeve që duken jo-normalisht të ulëta apo të larta.

Qëndrimi i Autoritetit Kontraktues (AK):

AK konfirmon se ka aplikuar procedurën përkatëse sipas nenit 61 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), duke dërguar shkresën standarde B41 për sqarim dhe kërkim të dokumentacionit mbështetës për një numër pozicionesh që janë identifikuar si potencialisht me çmime jo-normalisht të ulëta.

OE fitues ka kthyer përgjigje brenda afatit të caktuar (më datë 11.08.2025), duke përfshirë disa dokumente mbështetëse për të arsyetuar çmimet e ofertës.

Lidhur me pozicionet për të cilat është kërkuar dokumentacion mbështetës, përfshirë edhe pozitat nr. 1, 54 dhe 61 – të cilat theksohen në pretendimin e OE ankuesit – AK ka dhënë këtë deklaratë:

“Komisioni përgjigjen e dhënë nga Grupi OE i rekomanduar e ka vlerësuar si të mjaftueshme dhe e ka trajtuar këtë ofertë si të përgjegjshme në përputhje me legjislacionin përkatës për prokurimin publik.”

Në përputhje me nenin 29, paragrafi 29.4 të Rregullores nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, për të siguruar mbulim ndaj dëmeve apo shpenzimeve të mundshme në rast të ndërprerjes së kontratës, AK ka vendosur të rrisë vlerën e sigurimit të ekzekutimit nga 9,000.00 euro në 27,000.00 euro për një periudhë prej 25 muajsh.

Grupi OE i rekomanduar ka pranuar me shkrim këtë rritje të sigurimit të ekzekutimit më datë 12.08.2025, para nënshkrimit të kontratës.

Si rrjedhojë, AK konsideron se pretendimi për një ofertë jo-normalisht të ulët është i pabazuar.

Vlerësimi i Ekspertit për Pretendimin Nr. 2:

Eksperti konstaton se AK ka ndjekur procedurat ligjore për trajtimin e ofertave të dyshimta sipas nenit 61 të LPP-së, përfshirë dërgimin e shkresës B41 dhe kërkesën për dokumentacion mbështetës, gjë që tregon për një përpjekje serioze dhe transparente në vlerësimin e ofertave.

Edhe pse për disa pozicione specifike – si pozicioni 61 në Grupin D – dokumentacioni mbështetës nuk është paraqitur në mënyrë të plotë, përgjigjet e pranura dhe dokumentacioni tjetër i dorëzuar ofrojnë bazë të mjaftueshme për të mos e konsideruar ofertën si të papërgjegjshme.

Vendimi i AK për të rritur shumën e sigurimit të ekzekutimit përbën një masë të arsyeshme dhe proporcionale për të mbuluar rrezikun financiar që mund të rezultojë nga ofertat me çmime të ulëta, dhe dëshmon se AK nuk ka anashkaluar rrezikun, por e ka adresuar atë në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Përfundim për Pretendimin Nr. 2:

Pretendimi për çmime jo-normalisht të ulëta është i pabazuar. Edhe pse ka vende ku dokumentacioni mbështetës mund të ketë qenë i paplotë, nuk ka prova që ofertuesi fitues të mos jetë në gjendje të përmbushë kontratën, dhe AK ka marrë masa ligjore për sigurimin e kontratës.

PRETENDIMI Nr. 3 i OE Ankues

Përmbledhje e pretendimit:

OE ankues pretendon se oferta e Grupit “Bajram Ha. Gashi BI & Smart Eng Group SH.P.K.” për pozicionin 54 në Grupin D (specifikimet e ashensorit, modeli ELECTRIC MRL STA TTIO, vlerë e ofertës së tyre 6,100.00€/copë, kurse ne kërkesën për rishqyrtim ky çmim pretendohet se është 3,300.00euro, me ankesë OE ankues e ka theksuar te përmirësuar) është shumë e ulët krahasuar me çmimin e tregut (~18,000.00 €/copë).

Qëndrimi i AK:

AK kundërshton pretendimin duke deklaruar se çmimi i ofertës që ofron Grupi “Bajram Ha. Gashi & Smart Eng Group SH.P.K.” për këtë pozicion nuk është 3,300 € siç pretendon OE ankues, por 6,100 €.

Vlerësimi i Ekspertit për Pretendimin Nr. 3:

Eksperti pranon se OE ankues ka bërë një krahasim të çmimit të ofertës së Grupit Bajram Ha. Gashi & Smart Eng me një çmim tregu të pritshëm (~18,000 €), por gjen se krahasimi është gabim ose i pasaktë, sepse oferta e vërtetë është 6,100 €, jo 3,300 €.(ka dallime ne kërkesën për rishqyrtim dhe ne ankesën e OE ankues)

Eksperti thekson se pretendimi për çmimin e lartë krahasues duhet bërë me dokumente tregu, fatura, kontrata të furnizimeve të ngjashme; OE ankues nuk ka sjellë prova të tilla që të provojnë se oferta për këtë pozicion prej 6,100 € nuk është realiste ose se nuk mund të përmbushet.

Përfundim për Pretendimin Nr. 3:

Pretendimi është i pabazuar, sepse nuk janë dhënë prova të mjaftueshme që oferta për këtë pozicion prej 6,100 € është jashtë mundësive teknike ose profesionale.

KONKLuzion I Përgjithshëm

Pas shqyrtimit të gjitha pretendimeve (1, 2 dhe 3), përgjigjeve të Autoritetit Kontraktues dhe dokumentacionit mbështetës, ekspertit i duket se procedura e prokurimit është zhvilluar në përputhje të plotë me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Rregulloret për Prokurim Publik.

Nuk ka pasur shkelje ligjore thelbësore që të justifikojnë refuzimin e vendimit të AK për shpërbllim me kontratë.

Pretendimet e OE ankues nuk janë provuar në mënyrë të besueshme dhe nuk ndryshojnë përfundimin e ligjshmërisë së vendimit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të bazuara , mirpo pa mjaftueshmëri që procedura të kthehet në Rivlersim per arsye se edhe vet AK-ja ka konstatuar që çmimet e ofruar nga OE i rekomanduar janë çmime anomalisht të ulëta për qka dhe ka kërkuar sqarim sikurse parashihet ne nenin 61 të LPP-se, dhe nenit 41 i Rregullores për Prokurimin Publik 002/2024 Ndryshim-Plotësimi i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publikperveq tjerash AK-ja ka kërkuar edhe ritjen e sigurimit ekzekutivë të kontratës në raste të nënshkrimit të kontratës. Andaj, Paneli Shqyrtues mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që B58 Njoftim mbi vendimin e AK-se KOMUNA E MAMUSHËS të mbetet në fuqi. , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse”, me numër të prokurimit 626-25-5557-5-2-1.

Përfundim-

Paneli shqyrtues thekson faktin se Autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Poashtu Panei Shqyrtues vlereson sikurse parashihet ne nenin Neni 24 citoj 2. Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj” si dhe neni 59 citoj 1. *Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë*

individuale për vlerësimin e kryer të ofertës''.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4, dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E MAMUSHËS**
- **OE - Eko Term SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: